



11.3.2015

UDHËZUES I PËRDORIMIT PËR SISTEMIN E DEKLARIMIT ELEKTRONIK

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

Përmbajtja

1. Hyrje.....	2
2. Kyçja e shrytëzuesve të autorizuar në EDI	3
2.1. Hapja e llogarisë.....	5
2.2. Rigjenerimi i fjalëkalimit	7
2.3. Ndryshimi i email adresës.....	8
3. Deklarimi i tatimeve.....	10
3.1. Llojet e deklaratave tatimore në EDI	14
4. Korigjimi i tatimeve	15
5. Obligimet e papaguara.....	15
6. Pagesa online e tatimeve	18
7. Historia e deklarimeve	18
8. Bilanci tatimor	19
9. Ndryshimi i profilit	20
10. Ndryshimi i fjalëkalimit	21

Lista e figurave

Figura 1:Forma për kyçje	3
Figura 2: Pasqyra e tatimpaguesit.....	4
Figura 3:Forma për hapjen e llogarisë	5
Figura 4: Mesazhi pas regjistrimit të suksesshëm	6
Figura 5: Forma për rigjenerim të fjalëkalimit	7
Figura 6: Forma për ndryshimin e email adresës.....	8
Figura 7: Mesazhi pas tentimit të ndryshimit të emailit.....	9
Figura 8:Lista e deklaratave të padeklaruara për tatimpaguesin përkatës	10
Figura 9:Lista e deklaratave të padeklaruara pas zgjedhjes së deklaratës për raportim	11
Figura 10:Formulari i deklarimit për TV	12
Figura 11:Shfaqja e pop-up faqes pas validimit të të dhënave në formularin TV	13
Figura 12:Forma pas ruajtjes të të dhënave	13
Figura 13: Lista e deklaratave të deklaruara paraprakisht	15
Figura 14:Lista e deklaratave të papaguara për tatimpaguesin përkatës	16
Figura 15:Fletëpagesa, për tatimin e deklaruar dhe të papaguar për periudhën përkatëse	17
Figura 16: Forma për pagesë të tatimeve.....	18
Figura 17: Forma <i>Historia e deklarimeve</i>	19
Figura 18: Forma <i>Bilanci tatimor</i>	19
Figura 19: Forma <i>Ndrysho profilin</i>	20

Figura 20: Forma për ndryshim të fjalëkalimit..... 21

1. Hyrje

Qëllimi kryesor i *Sistemit për Deklarim Elektronik (EDI-t)* të ri, është që të shërbejë si platformë, e cila ju mundëson tatimpaguesve deklarin dhe pagesat e tatimit *online* me disa shërbime shtesë dhe lehtësime gjatë përdorimit si në vijim:


- Deklarimin dhe pagesën e të gjitha tatimeve dhe Kontributeve Pensionale;
- Gjenerimin e fletëpagesës për borxhet e pashlyera që nga viti 2011;
- Pasqyra mbi gjendjen e tatimpaguesit që nga viti 2011;
- Gjenerimin e Vërtetimit Tatimor për biznese;
- Raportimin e Blerjeve mbi 500€;
- Caktimin e personit të autorizuar;
- Ndryshimin e profilit dhe fjalëkalimit;
- Kontrollimin e historisë dhe bilancit tatimor;
- Kërkesë për ndihmë, etj.

Aktualisht kanë hapur llogari, për të deklaruar dhe paguar tatimet, gjithsej 45563 tatimpagues.

Në vazhdim është përgatitur udhëzuesi i përdorimit për nevojat e shfrytëzuesve të *Sistemit të ri për deklarin elektronik*, i cili përfshinë përshkrimin e udhëzimeve të përdorimit kryesisht për tatimpaguesit.

2. Kyçja e shfrytëzuesve të autorizuar në EDI


Pas shfaqjes së faqes për logim, shfrytëzuesi shënon username-in dhe fjalëkalimin. Pas klikimit në “Kyçu” dhe pas kontrollimit të shfrytëzuesit, fjalëkalimit dhe kodit verifikues nga sistemi, shfrytëzuesit i lejohej çasja në sistem. Nëse shfrytëzuesi, fjalëkalimi dhe kodi nuk aprovohen, pra nëse janë shënuar gabimisht, shfrytëzuesit i lejohej të provojë përsëri duke u shfaqur mesazhi “Shfrytëzuesi ose fjalëkalimi është gabim. Ju lutem sigurohuni nëse i keni shkruar saktë.”



The screenshot shows the login interface for the Electronic Declaration System (EDI). At the top left is the logo of the Tax Administration of Kosovo. Below it, the text reads: "Administrata Tatimore e Kosovës", "Poreska Administracija Kosova", and "Tax Administration of Kosovo". To the right of the logo is a red button labeled "Ballina". Further right are language selection buttons for "ALB", "SRB", and "ENG". The main content area is divided into two sections by a vertical red line. On the left, under the heading "Kyçu", there are three input fields: "Shfrytëzuesi" (Username), "Password", and a CAPTCHA field labeled "QZsk" with the instruction "Shkruani kodin në imazh". Below these fields is a red "Log in" button. On the right side, there are three links: "Nuk keni llogari të hapur? [Regjistrohuni](#)", "Keni harruar fjalëkalimin? [Rigjenero](#)", and "Keni gabuar email adresën? [Ndrysho emailin](#)".

Figura 1: Forma për kyçje

Pasi shfrytëzuesi kyçet, në sistem shfaqet pasqyra e tatimpaguesit e cila ndahet në tri pjesë: profilin e tatimpaguesit, ndërmarrjet e tij, dhe llogaritë tatimore të hapura (Figura 2).



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ballina Deklaratat Raportet Sherbimet Profili Ndhilma ALB SRB ENG

Pasqyra e tatimpaguesit

Profili

Nr.Fiskal	601138177	Kontakti	
Tatimpaguesi	JURIDIK	Adresa	
Regjioni	PRISHTINË 1	Tel	044145758
Lloji Kompanisë	SH.P.K	Aktiviteti kryesor	Agjencitë e patundshmerive

Ndërmarrjet

NRB	Ndërmarrja	Kryesore	Data e fillimit	Data e mbylljes
99999999	TEST CORP	PO	28.10.2009	

Llogarit tatimore

Nr	Lloji tatimit	Data e regjistrimit	Data e mbylljes
1	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	01.01.2011	
2	[WM] Pasqyrë e mbajtjes në burim dhe pagimit të tatimit	01.01.2011	
3	[CM] Pasqyra e kontributeve për pension dhe formulari i dërgesës	01.01.2011	
4	[CI] Formulari i raportit tremujor të kontributeve individuale	01.01.2011	
5	[IS] Kestet tremujore për Bizneset e Vogla Individuale	01.01.2011	
6	[IL] Kestet tremujore për Bizneset e Mëdha Individuale	01.01.2011	
7	[QS] Kestet tremujore per Korporatat e Vogla	01.01.2011	
8	[QL] Kestet tremujore per Korporatat e Medha	01.01.2011	
9	[CD] Deklarata vjetore e tatimit mbi korporata	28.10.2009	
10	[PD] Deklarata vjetore e tatimit personal	01.01.2011	
11	[DO] DEKLARATA VJETORE E TË ARDHURAVE NGA ORTAKRIA	01.01.2010	

© 2015 - Administrata Tatimore e Kosovës


Figura 2: Pasqyra e tatimpaguesit

Pasqyra e tatimpaguesit gjendet edhe në menynë kryesore tek *Raportet/Pasqyra e tatimpaguesit*. Para se shfrytëzuesi të logohet në *Sistemin e deklarimit elektronik (EDI)*, duhet të ketë llogari të hapur.

2.1. Hapja e llogarisë

Shfrytëzuesit të cilët nuk kanë llogari të hapur paraprakisht, duhet ta hapin atë duke u regjistruar në linkun “Regjistrohuni”, në formën për login (Figura 1:Forma për kyqje).

Plotësohen fushat e shfaqura si në vijim:



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ballina Deklaratat Raportet Sherbimet Profili Ndihma ALB SRB ENG

Regjistrimi i llogarisë për deklarim elektronik

Numri Fiskal

Emri

Numri personal

Telefoni

Email

Konfirmo Email

Pranoj kushtet e kontratës

© 2015 - Administrata Tatimore e Kosovës

Figura 3:Forma për hapjen e llogarisë

1. *Numri Fiskal* - Shëno numrin fiskal
2. *Numri Personal* - Shëno numrin personal
3. *Telefoni* - Shëno numrin e telefonit
4. *Email* - Shëno e-mail adresën ku do të dërgohet fjalëkalimi juaj
5. *Konfirmo Email* - Ri përsërit email adresën
6. *Pranoj kushtet e kontratës* - Kliko ne katrorin për tu pajtuar me kushtet e kontratës të përdorimit të këtij sistemi

Pas plotësimit të fushave, klikohet në butonin “Regjistrohu”, me ç’rast shfrytëzuesit do ti dërgohet një email me kredencialet përkatëse (shfrytëzuesin dhe fjalëkalimin). Pas regjistrimit të suksesshëm (dmth kur të gjitha të dhënat nëpër fusha janë dhënë saktë nga tatimpaguesi), shfaqet mesazhi sikurse në figurën vijuese:



Figura 4: Mesazhi pas regjistrimit të suksesshëm


Në vazhdim janë paraqitur dy skenarë, ku tatimpaguesi dështon gjatë regjistrimit:

- Nëse të dhënat nuk janë të sakta në fushat e caktuara, shfrytëzuesit i bëhet me dije duke ju shfaqur një mesazh informues (p.sh. "Ky numër personal nuk është valid)
- Në rast të tentimit të regjistrimit me një numër fiskal, i cili është regjistruar njëherë, shfaqet mesazhi "Ky numër fiskal është regjistruar më parë".

2.2. Rigjenerimi i fjalëkalimit

Në rast të humbjes të fjalëkalimit, shfrytëzuesi(tatimpaguesi) ka mundësi ta rigjenerojë atë duke klikuar në linkun “Rigjenero” (Figura 1:Forma për kyqje).

Plotësohen fushat e shfaqura si në vijim:



The screenshot shows the web interface of the Tax Administration of Kosovo. At the top, there is a navigation bar with a logo on the left and a menu on the right containing 'Ballina', 'Deklaratat', 'Raportet', 'Sherbimet', 'Profilli', 'Ndihma', and language options 'ALB', 'SRB', 'ENG'. The main content area is titled 'Keni harruar fjalëkalimin?' and contains the following text: 'Përdorni formën më poshtë për ta rigjeneruar fjalëkalimin e ri në rast se e keni harruar. Pasi ta keni mbushur formën klikoni mbi butonin 'Rigjenero fjalëkalimin' dhe pastaj do të pranoni një email me fjalëkalimin e ri.' Below this text are three input fields: 'Numri Fiskal', 'Email', and 'Konfirmo Email'. A red button labeled 'Rigjenero fjalëkalimin' is positioned below the input fields.

Figura 5: Forma për rigjenerim të fjalëkalimit


- 1.Numri Fiskal -Sheno numrin fiskal
- 2.Email - Sheno email-in
- 3.Konfirmo Email – Ri përsërit email adresën

Pas plotësimit të fushave, klikohet në butonin “Rigjenero fjalëkalimin”, me ç’ rast shfrytëzuesit do ti dërgohet një email me fjalëkalimin e ri.

2.3. Ndryshimi i email adresës

Për ndryshimin e email adresës ekzistuese kliko në “Rigjenero fjalëkalimin” (Figura 1:Forma për kyqje).

Plotësohen fushat e shfaqura si në vijim:



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ballina Deklaratat Raportet Sherbimet Profili Ndihma ALB SRB ENG

Kërkesa për ndryshim të email adresës

Përdorni formën më poshtë për ta ndryshuar email adresën nëse eventualisht e keni dhënë gabim. Plotësoni shënimet dhe klikoni butonin 'Regjistro kërkesë', më pastaj kërkesa juaj do të shqyrtohet dhe do të kontaktoheni nga një zyrtar i ATK-së për verifikim.

Numri Fiskal

Tel

Email

Konfirmo Email

Regjistro kërkesën

Figura 6: Forma për ndryshimin e email adresës

1. *Numri Fiskal* - Sheno numrin fiskal
2. *Tel* - Sheno nr e telefonit
3. *Email* – Sheno email adresën ku do të dërgohet emaili i ri
4. *Konfirmo Email* – Ri përsërit email adresën

Pas plotësimit të fushave, klikohet në butonin “Rigjenero kërkesën”, me ç’ rast shfrytëzuesit do ti dërgohet email adresa e re.

- Në rast se email adresa është shenuar gabimisht gjatë regjistrimit ([2.1.Hapja e llogarisë](#)) dhe tentohet të ndryshohet emaili , atëherë shfaqet mesazhi sikurse në figurën në vijim:





Figura 7: Mesazhi pas tentimit të ndryshimit të emailit

3. Deklarimi i tatimeve

Në menynë kryesore pas zgjedhjes *Deklaratat /Deklarimi i tatimeve*, listohen të gjitha deklaratat e padeklaruara për tatimpaguesin përkatës në bazë të periudhës dhe llojit të deklaratës.

Në listë duhet të shfaqen deklaratat tatimore për të cilat është e hapur llogaria tatimore për tatimpaguesin përkatës.




The screenshot shows the web interface of the tax administration. At the top, there is a navigation bar with the logo and name of the Tax Administration of Kosovo, and a menu with options like 'Ballina', 'Deklaratat', 'Raportet', 'Sherbimet', 'Profili', and 'Ndihma'. There are also language selection buttons for 'ALB', 'SRB', and 'ENG'. Below the navigation bar, the main heading is 'Deklarimi i Tatimeve'. A table displays a list of tax returns with columns for '#', 'Lloji i tatimit', 'Muji', 'Viti', and 'Afati'. The table contains five rows of data. Below the table, there is a pagination control showing '1' as the current page, '5' as the number of items per page, and '1 - 5 prej 98 rreshtave'. A red 'Deklaro' button is located below the table. At the bottom left, there is a copyright notice: '© 2015 - Administrata Tatimore e Kosovës'.

#	Lloji i tatimit	Muaji	Viti	Afati
1	[QS] Kestet tremujore per Korporatat e Vogla	3	2015	15.04.2015
2	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	2	2015	20.03.2015
3	[IS] Kestet tremujore për Bizneset e Vogla Individuale	3	2015	15.04.2015
4	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	1	2015	20.02.2015
5	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	12	2014	20.01.2015

Figura 8:Lista e deklaratave të padeklaruara për tatimpaguesin përkatës

Varësisht prej llojit të deklarimit hapet edhe forma për deklarim. Shfrytëzuesi zgjedh deklaratën (në rastin tonë formulari TV; Ekzistojnë 13 lloje të formulrëve – shih 3.1) të cilën dëshiron të raportojë dhe pas klikimit në “Deklaro” hapet forma për deklarim (Figura 10). Pas raportimit të deklaratave, ato do të ruhen tek *Historia e deklarimeve*, ku shfrytëzuesi do të jetë i informuar se çka është deklaruar.



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ballina Deklaratat Raportet Sherbimet Profili Ndhima ALB SRB ENG

Deklarimi i Tatimeve

#	Lloji i tatimit	Muaji	Viti	Afati
1	[QS] Kestet tremujore per Korporatat e Vogla	3	2015	15.04.2015
2	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	2	2015	20.03.2015
3	[IS] Kestet tremujore për Bizneset e Vogla Individuale	3	2015	15.04.2015
4	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	1	2015	20.02.2015
5	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	12	2014	20.01.2015

5 rreshta për faqe 1 - 5 prej 98 rreshtave

[Deklaro](#)

© 2015 - Administrata Tatimore e Kosovës

Figura 9:Lista e deklarave të padeklaruara pas zgjedhjes së deklarës për raportim

Disa nga fushat në format e deklarimit plotësohen automatikisht nga sistemi. Poashtu fushat kalkulative do të kalkuloohen dhe do të plotësohen automatikisht nga sistemi.

TVSH

FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TVSh-së

[1] Periudha tatimore	<input type="text" value="2 2015"/>	[2] Uniref	<input type="text" value="MFA2C800000501P"/>
[3] Numri Fisikal	<input type="text" value="601138177"/>		
[4] Emri i personit të tatueshëm	<input type="text" value="TEST CORP"/>		
[5] Adresa e personit	<input type="text"/>		
[6] Emri i personit kontaktues	<input type="text"/>	[7] Numri i personit kontaktues	<input type="text" value="044145758"/>

[9] Furnizimet e përjashtuara pa të drejtë kreditimi	<input type="text" value="0.00"/>	
[10] Furnizimet e trajtuara si eksporte me të drejtë kreditimi	<input type="text" value="0.00"/>	
[11] Eksportet	<input type="text" value="0.00"/>	
[12] Shitjet e tatueshme me normën 15%	<input type="text" value="0.00"/>	[13] <input type="text" value="0.00"/>
[14] Nota debitore e lëshuar dhe nota kreditore e pranuar	<input type="text" value="0.00"/>	[15] <input type="text" value="0.00"/>
[16] Fatura e borxhit të keq e pranuar dhe Inkaasmi i B.K	<input type="text" value="0.00"/>	[17] <input type="text" value="0.00"/>
[18] Rregullimet për të rritur TVSH-në për pagesë	<input type="text" value="0.00"/>	[19] <input type="text" value="0.00"/>
[20] Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt	<input type="text" value="0.00"/>	[21] <input type="text" value="0.00"/>
		[22] <input type="text" value="0.00"/>
		Totali i Tvshes ne fuqetur
[23] Blerjet dhe importet pa TVSH	<input type="text" value="0.00"/>	
[24] Blerjet dhe importet investive pa TVSH	<input type="text" value="0.00"/>	
[25] Blerjet dhe importet me TVSH jo të zbritshme	<input type="text" value="0.00"/>	
[26] Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme	<input type="text" value="0.00"/>	
[27] Importet e tatueshme	<input type="text" value="0.00"/>	[28] <input type="text" value="0.00"/>
[29] Importet investive të tatueshme	<input type="text" value="0.00"/>	[30] <input type="text" value="0.00"/>
[31] Blerjet e tatueshme vendore	<input type="text" value="0.00"/>	[32] <input type="text" value="0.00"/>
[33] Blerjet investive të tatueshme vendore	<input type="text" value="0.00"/>	[34] <input type="text" value="0.00"/>
[35] Nota debitore e pranuar dhe nota kreditore e lëshuar	<input type="text" value="0.00"/>	[36] <input type="text" value="0.00"/>
[37] Fatura e borxhit të keq e lëshuar dhe pagesa e B.K	<input type="text" value="0.00"/>	[38] <input type="text" value="0.00"/>
[39] Rregullimet për të ulur TVSH-në për pagesë	<input type="text" value="0.00"/>	[40] <input type="text" value="0.00"/>
[41] E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt	<input type="text" value="0.00"/>	[42] <input type="text" value="0.00"/>
		[43] <input type="text" value="0.00"/>
		Totali i Tvshes ne zbritshme
[44] Teprica a Tvsh-së e bartur nga muaji i kaluar	<input type="text" value="0.00"/>	
[45] Balanca kreditore e mbetur 45 = ((43-44)-22)>0	<input type="text" value="0.00"/>	
[46] Kërkesa për rimbursim	<input type="text" value="0.00"/>	
[47] Kreditimi i tvsh-së për muajin pasues 47 =(45-46)	<input type="text" value="0.00"/>	
[48] TVSH që duhet të paguhet 48 =(22-43-44)>0	<input type="text" value="0.00"/>	

Deklaro
Anulo

Figura 10:Formulari i deklarimit për TV

Në formën e hapur plotësohen të dhënat për fushat përkatëse, shtypet butoni “Deklaro”(Figura 10) dhe pas validimit të të dhënave, shfaqjes së pop-up faqes me të dhënat përkatëse, shtypet “Deklaro”(fig.7).

The screenshot displays a web interface for tax declarations. A central pop-up window titled 'Deklaro' is open, containing the following fields:

- Numri Fiskal: 601138177
- Uniref: MFA2C8000000501P
- Lloji tatimit: TVSH
- Periodha: 2/2015
- Shuma: 0.00

Buttons for 'Deklaro' (blue) and 'Mbylle' (red) are located at the bottom of the pop-up. The background shows a grid of tax items with values of 0.00 and a 'Deklaro' button at the bottom center.

Figura 11:Shfaqja e pop-up faqes pas validimit të të dhënave në formularin TV

Për të anuluar plotësimin të të dhënave në formularin e hapur klikohet në “Mbylle”

Të dhënat ruhen dhe shfaqet mesazhi “Deklarata është regjistruar me sukses”.

The screenshot shows a success message on the website. At the top, there is a navigation bar with the logo and name of the Tax Administration of Kosovo. Below the navigation bar, a green checkmark icon is followed by the text 'Deklarata është regjistruar me sukses'. Below this message are two buttons: 'Shtype Fletëpagesën' (blue) and 'Kthehuni në listën e deklarave të padeklaruara' (blue).

Figura 12:Forma pas ruajtjes të të dhënave

Në këtë rast shfaqen dy opsione: “Shtype fletëpagesën” (tatimpaguesi e shtyp fletëpagesën e gjeneruar nga deklarata përkatëse) dhe “Kthehuni në listën e deklarave të padeklaruara” (tatimpaguesi kthehet tek lista e deklarave të padeklaruara Figura 8).

3.1. Llojet e deklaratave tatimore në EDI

Në Sistemin e ri EDI mund të deklarohen këto lloje të tatimeve të cilat janë paraqitur me shkurtesat përkatëse:

1. [TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar
2. [WM] Pasqyra mujore e tatimit në burim
3. [CM] Pasqyra e kontributeve për pension dhe formulari i dërgesës
4. [CI] Formulari i raportit tremujor të kontributeve individuale
5. [WR] Pasqyra mujore e mbajtjes në burim dhe pagesës së tatimit në interes, të drejta pronësore, qira, fitore në lotari dhe lojëra të fatit dhe personin jo-rezident
7. [IS] Këstet tremujore për Bizneset e Vogla Individuale
8. [IL] Këstet tremujore për Bizneset e Mëdha Individuale
9. [IR] Tatimi mbi Qiratë dhe Pasurinë e Patrupëzuar
10. [QS] Këstet tremujore për Korporatat e Vogla
11. [QL] Këstet tremujore për Korporatat e Mëdha
12. [CD] Deklarata vjetore e tatimit mbi korporata
13. [PD] Deklarata vjetore e tatimit personal
14. [DO] Deklarata vjetore e të Ardhurave nga Ortakëria

4. Korigjimi i tatimeve

Në menynë kryesore pas zgjedhjes *Deklaratat/Korigjimi i tatimeve*, shfaqen të gjitha llojet e tatimeve të deklaruara më herët për tatimpaguesin përkatës në bazë të periudhës dhe llojit të deklaratës.





Figura 13: Lista e deklaratave të deklaruara paraprakisht

Në dropdown listën “Lloji i tatimit” si në figurën e mësipërme, zgjedhet lloji i deklaratës, kurse tek “Periudha tatimore” zgjedhet periudha tatimore e llojit të deklaratës, e cila duhet të korigjohet. Pas klikimit në butonin “Vazhdo”, shfaqet formulari i cili duhet të korigjohet, plotësohen fushat me të dhënat e sakta dhe shtypet në butonin “Korigjo”; kurse butoni “Reseto” i pastron fushat “Lloji i tatimit” dhe “Periudha tatimore”.

5. Obligimet e papaguara

Në mënyrë kryesore pas zgjedhjes *Deklaratat /Obligimet e papaguara*, listohen të gjitha deklaratat për pagesë. Kjo formë shërben për pagesë dhe shtypje të fletëpagesës, së tatimit të dekluar dhe të paguar për periudhën përkatëse.

Shfrytëzuesi zgjedh deklaratën të cilën dëshiron t’a shtypë dhe klikon në “Shtyp fletëpagesën”.



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ballina Deklaratat Raportet Sherbimet Profili Ndhima ALB SRB ENG

Obligimet e Papaguara

#	Lloji i tatimit	Muaji	Viti	Afati	Detyrimi	Pagesa	Bilanci
1	formulari i dërgesës		2014	15.08.2014	-104.3	0	-104.3
2	[CM] Pasqyra e kontributeve për pension dhe formulari i dërgesës	7	2014	15.08.2014	-104.3	0	-104.3
3	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	3	2011	20.04.2011	-8952.2	8952.2	-2055
4	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	2	2011	21.03.2011	-2680.85	2680.85	-250
5	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	1	2011	21.02.2011	-2655.91	2655.91	-100

5 rreshta për faqe 6 - 10 prej 10 rreshtave

Shtyp Fletëpagesën

© 2015 - Administrata Tatimore e Kosovës

Figura 14:Lista e deklaratave të papaguara për tatimpaguesin përkatës

Pas zgjedhjes “Shtyp fletëpagesën” do të shkarkohet fletëpagesa përkatëse si në figurën vijuese:



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Financave - Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance
 Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



FLETËPAGESA

Lloji i tatimit: [TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar  MFA2C80000005071

Periudha Tatimore: 3 2011

Numri Fiskal: 601138177

Emri i biznesit/individit: TEST CORP

Data Deklarimit: 16/03/2015 10:20 Shuma për pagesë: 2,055.00

Pjesa e bankës

Vula/Nenshkrimi:	Numri i llogaritë: 1000420070000373	Shuma e pagesës:
	Teksti:	_____ €
	Data: __/__/_____	



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Financave - Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance
 Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



FLETËPAGESA

Lloji i tatimit: [TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar  MFA2C80000005071

Periudha Tatimore: 3 2011

Numri Fiskal: 601138177

Emri i biznesit/individit: TEST CORP

Data Deklarimit: 16/03/2015 10:20 Shuma për pagesë: 2,055.00

Pjesa e bankës

Vula/Nenshkrimi:	Numri i llogaritë: 1000420070000373	Shuma e pagesës:
	Teksti:	_____ €
	Data: __/__/_____	

Figura 15: Fletëpagesa, për tatimin e deklaruar dhe të papaguar për periudhën përkatëse

Në rastin e pagesave parciale, dmth kur tatimpaguesi e paguan një pjesë të borgjit, në formën për shtypje të fletëpagesës gjenerohet UNIREF-i i ri me pjesën e mbetur të shumës pas pagesës.

6. Pagesa online e tatimeve

Në mënyrë kryesore pas zgjedhjes *Deklaratat /Pagesa online e tatimeve*, listohen të gjitha bankat nëpërmjet të cilave tatimpaguesi mund të paguaj tatimet.




Figura 16: Forma për pagesë të tatimeve

Për të paguar llojin e tatimit të caktuar, zgjedhet banka në të cilën tatimpaguesi ka llogari, dhe klikohet në butonin “Vazhdo”, me ç’rast hapet forma e bankës përkatëse, ku tatimpaguesi duhet të shenojë kredencialet për kyçje.

7. Historia e deklarimeve

Në mënyrë kryesore pas zgjedhjes *Raportet/Historia e deklarimeve*, listohet historia e deklarimeve së të gjitha deklaratave për tatimpagues në formë tabelare si në figurën vijuese:

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ballina Deklaratat Raportet Sherbimet Profili Ndhima ALB SRB ENG

Historia e Deklarimeve

#	Lloji i tatimit	UNIREF	Muji	Viti	Data	Shuma
1	[TV] Tatimi i Vlerës së Shtuar	MFA2C8000000501P	2	2015	13.03.2015	0.00
2	[DO] DEKLARATA VJETORE E TË ARDHURAVE NGA ORTAKRIA	MFADO8000000500M		2014	13.03.2015	-50.00
3	[WM] Pasqyrë e mbajtjes në burim dhe pagimit të tatimit	MFA2E80000004958	9	2014	12.03.2015	0.00

3 rreshta për faqe 1 - 3 prej 3 rreshtave

Shkarko Deklaraten Shtyp Fletëpagesen

© 2015 - Administrata Tatimore e Kosovës

Figura 17: Forma *Historia e deklarimeve*

Në këtë tabelë ruhen të gjitha deklaratat që deklarohen nga tatimpaguesi. Për të shkarkuar deklaratën për llojin e caktuar të tatimit, shtypet në butonin “Shkarko Deklaratën”, kurse për të shtypur shkarkuar fletëpagesën përkatëse, klikohet në butonin “Shtyp fletëpagesën”.

8. Bilanci tatimor

Në menynë kryesore pas zgjedhjes *Raportet/Bilanci tatimor*, shfaqet faqja si në figurën vijuese:

Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Ballina Deklaratat Raportet Sherbimet Profili Ndhima ALB SRB ENG


Shfaq Raportin Zgjedhe llojin e tatimit

Figura 18: Forma *Bilanci tatimor*

Për shfaqjen e bilancit tatimor të llojit të caktuar të tatimit, zgjedhet lloji i tatimit dhe klikohet në butonin “Shfaq raportin”.

9. Ndryshimi i profilit

Kjo formë shërben për lexim dhe ndryshim të të dhënave personale të tatimpaguesit. Pas zgjedhjes *Profili/Ndrysho profilin*, në menynë kryesore do të shfaqen fushat e plotësuara nga sistemi.



The screenshot shows the 'Ndrysho profilin tuaj' (Change your profile) form. At the top, there is a navigation bar with the logo of the Tax Administration of Kosovo and the text 'Administrata Tatimore e Kosovës Poreska Administracija Kosova Tax Administration of Kosovo'. Below the logo, there are menu items: 'Ballina', 'Deklaratat', 'Raportet', 'Sherbimet', 'Profill', and 'Ndihma'. On the right side of the navigation bar, there are language options: 'ALB', 'SRB', and 'ENG'. The main content area is titled 'Ndrysho profilin tuaj' and contains several input fields for personal information:

- Numri Fiskal**: 601138177
- Emri**: TEST CORP
- Numri personal**: 1003758300
- Telefoni**: 044384881
- Email**: gazmendmehmeti@gmail.com
- Konfirmo Email**: (empty field)

At the bottom of the form, there is a red button labeled 'Ndrysho'.

© 2015 - Administrata Tatimore e Kosovës


Figura 19: Forma *Ndrysho profilin*

Vetëm fushat e paracaktuara për ndryshim do të bëhen do t’u mundësohet ndryshimi i të dhënave.

Shfrytëzuesi i ndryshon fushat e caktuara dhe pasi klikohet në butonin “Ndrysho”, shfaqet mesazhi: “Të dhënat u ndryshuan me sukses”.

10. Ndryshimi i fjalëkalimit

Në sistemin EDI ekziston edhe mundësia e ndërrimit të fjalëkalimit të shfrytëzuesit të aplikacionit. Shfrytëzuesi zgjedh *Profili/Ndrysho fjalëkalimin* në mënyrë kryesore ku hapet forma për ndërrim të fjalëkalimit.



The screenshot shows a web interface for changing a password. At the top, there is a navigation bar with the logo of the Tax Administration of Kosovo and the text 'Administrata Tatimore e Kosovës Poreska Administracija Kosova Tax Administration of Kosovo'. The navigation bar includes a 'Ballina' button and several dropdown menus: 'Deklaratat', 'Raportet', 'Sherbimet', 'Profili', and 'Ndhima'. On the right side of the navigation bar, there are language selection buttons for 'ALB', 'SRB', and 'ENG'. The main content area is titled 'Ndrysho fjalëkalimin tuaj' and contains three input fields: 'Fjalëkalimi i vjetër', 'Fjalëkalimi i ri', and 'Konfirmo fjalëkalimin'. Below these fields is a red button labeled 'Ndrysho'. At the bottom left of the page, there is a copyright notice: '© 2015 - Administrata Tatimore e Kosovës'.

Figura 20: Forma për ndryshim të fjalëkalimit

Në këtë formë plotësohen të dhënat përkatëse: fjalëkalimi i vjetër, fjalëkalimi i ri dhe konfirmimi i fjalëkalimit. Validohet fjalëkalimi, sepse fjalëkalimi duhet t'i përmbahet rregullave për validim dhe shtypet "Ndrysho" me ç' rast fjalëkalimi ndërrohet.